

---

**AKT-THEMELIMI DHE STATUTI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“EUROCES” SH.P.K**

**KREU I - THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA**

**NENI 1**

**DATA E THEMELIT, EMRI DHE THEMELUESIT**

Sot, më date 08 Tetor 2022, unë, themeluesi, kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin “EUROCES”

Themeluesi i shoqërisë është Fran Marku – me nr. Personal J21007044Q

**Neni 2**

**QËLLIMI I THEMELIT TË SHOQËRISË**

Qëllimi i themelimit të Shoqërisë është qëllim i ligjshëm afarist, përfitimi personal i ortakëve dhe kontributi shoqëror në vendin ku jetojmë, me kontribute që kanë në thelb rritjen e rritjen e mireqënies personale dhe të shoqërisë në përgjithësi.

**Neni 3**

**FORMA DHE EMRI LIGJOR I SHOQERISE**

Shoqëria Tregtare është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, shkurtimisht **SH.P.K.**

Emërtimi i plotë i shoqërisë është: Shoqëria Tregtare “**EUROCES**” shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

**Neni 4**

**ADRESA E SELISË**

Selia e “EUROCES”sh.p.k. është në “Rruga Karl Gega, Pall. 11, Shk.4, K.9,Ap.29, Tiranë, Shqipëri”.

**Person i autorizuar** i kësaj shoqërie tregtare është z. Fran Marku i cili është person i ligjshëm për pranimin e shërbimeve, njoftimeve, kërkesave si dhe akteve tjera që dërgohen nga autoritetet publike apo private.

Shoqëria mund të themelojë filiale, të hapë njësi brenda vendit në perputhje me legjislacionin në fuqi.

## Neni 5

### OBJEKTI I AKTIVITETIT TË SHOQËRISË

Objekt i aktivitetit të shoqërisë do të jetë çdo veprimtari e lejuar nga ligji, me pjesëmarrje në çdo aktivitet të ligjshëm që mund të kryejë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e krijuar në bazë të legjisllacionit shqiptar, sic mund të ndryshohet here pas here dhe në vecanti verpimtarite e mëposhtme:

Hartimi i projekteve të ndërtimit

Ndërtimi i ndërtesave rezidenciale dhe jo rezidenciale

Aktivitete arkitekturore

Aktivitete inxhinierike dhe konsulenca teknike të lidhura me to

Testimet dhe analizat teknike

Ndërtimi i rrugëve dhe autostradave

Ndërtimi i veprave të tubacioneve e kanalizimeve

Ndërtimi i veprave të shërbimit komunal për energjinë elektrike dhe telekomunikacione

Ndërtimi i veprave ujore

Ndërtimi i veprave të tjera të inxhinierisë civile p.k.t.

Përgatitja e kantierit të ndërtimit

Punime për prishje

Shpime

Instalime elektrike

Punime hidraulike, instalime të ngrohjes dhe kondicionimit të ajrit

Instalime të tjera elektrike

Punime suvatimi

Punime montimi

Punime për veshjen e dyshemeve dhe mureve

Lyerja dhe vendosja e xhamave

Punime të tjera përfundimtare dhe finicioni të ndërtesave

Punime të çatisë

Të tjera punime të specializuara ndërtimi p.k.t.

Aktivitete të ndërmjetësimit për shitjen e lëndës drusore dhe materialeve të ndërtimit

Tregtia me shumicë e drurit, materialeve të ndërtimit dhe pajisjeve hidrosanitare

Tregtia me shumicë e pjesëve elektronike, pajisjeve hidraulike

dhe të ngrohjes dhe pjesëve të tyre

Tregtia me shumicë e produkteve kimikë

Tregtia me shumicë e produkteve të tjerë ndërmjetës

Tregtia me shumicë e mbeturinave dhe skrapit

Transporti rrugor i mallrave

Shërbime të lëvizëshme

Magazinimi dhe ruajtja

Blerja dhe shitja e pasurive të paluajtshme në pronësi të vet

Dhënia me qira dhe funksionimi i pasurive të paluajtshme të veta ose të marra me qira

Menaxhim i pasurive të paluajtshme me pagesë ose kontratë

Aktivitete të drejtimit të ndërmarrjeve

Dhënia me qera dhe hua e mjeteve të transportit

Dhënia me qera dhe hua e kamionëve

Pastrimi i përgjithshëm i ndërtesave

Aktivitete të tjera pastrimi të ndërtesave dhe pastrimi i objekteve industrial

Import-eksport i mallrave me shumice

Aktivitete shërbimi të mirëmbajtjes dhe kujdesit të shesheve

Të gjitha veprimtaritë e Shoqërisë regjistrohen ne Qendren kombetare të biznesit, e cila vepron sipas legjislacionit ne fuqi.

## Neni 6

### PERIUDHA E KOHËZGJATJES SË SHOQËRISË

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë si sh.p.k. do të jetë për një afat të pacaktuar.

## KREU II - KAPITALI

### Neni 7

#### KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërisë tregtare është 500 000 (Pesëqind mije) Leke.

Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

- 1- Ortaku themelues Z. Fran Marku zotëron 1 kuote, me vlerë të përgjithshme 500 000 lekë (Pesëqind mije), që përbën 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

## Neni 8

### ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

## Neni 9

### TRANSFERIMI I KAPITALIT

Kuotat e kapitalit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Ne cdo rast transferimi i pjeseve të kapitalit themeltar me vullnetin e ortakut duhet të vertetohet nepermjet nje akti noterial.

## KREU III - ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

### Neni 10

#### ORGANI VENDIMMARRES

Organi Vendimmarres Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqërisë.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqërisë qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

## **Neni 11**

### **MËNYRA E THIRRJES SE MBLEDHJES SE ASAMBLESE SE PERGJITHSHME**

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike.

Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t’u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

## Neni 12

### VENDIMMARRJA

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zoteruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skeden e shoqërisë

## Neni 13

### ADMINISTRATORI

Administratori i parë i shoqërisë emërohet z. Fran Marku me numer personal J21007044Q emëruar në këtë detyrë me datë 08/10/2022 deri me datë 07/10/2027 me të drejtë përsëritje.

Për emërimet pas administratorit të parë, në aktin e emërimit përcaktohet edhe periudha e emërimit në detyrë. Në rast se kjo periudhë nuk është përcaktuar në aktin e emërimit, ajo në cdo rast nuk mund të jete më shumë se pesë vjet, duke filluar ky afat nga data e emërimit.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të asamblese së ortakëve.

## Neni 14

### KOMPETENCAT DHE KUFIZIMET E ADMINISTRATORIT

Administratori ka këto kompetenca:

- të paraqitet, përfaqësojë dhe nënshkruajë për shoqërinë,
- të ekzekutojë vendimet e Asmblese së ortakëve,
- të udhëheqë afarizmin e shoqërisë,
- të organizojë dhe udhëheqë me procesin e punës, kryen veprime bankare
- përgatit pasqyrat vjetore të kontabilitetit dhe raportet mbi afarizmin,
- propozon Vendimet të cilat i miraton Asmbleja e ortakëve,

- propozon organizimin e brendshëm të shoqërisë,
- i pranon në punë dhe iu shkëput Kontratën e punës punëmarrësve,
- vendos mbi sistemimin e punëmarrësve në vende punë ,
- kujdeset për ligjshmërinë e punës në shoqëri,
- vendos mbi procedurat disiplinore të të punësuarve,
- kryen edhe punë të tjera në harmoni me ligjin, Statutin dhe Vendimet e Asmblese se ortakeve.

## **KREU IV - VITI FINANCIAR-EKSPERTET**

### **Neni 15**

#### **VITI FINANCIAR**

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor.

Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

### **Neni 16**

#### **EKSPERTET**

Eksperti ka per detyre qe të kontrolloje të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer nje gje të tillë i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar qe t’ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t’i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.

## **KREU V PRISHJA – RIORGANIZIMI I SHOQËRISË**

### **Neni 17**

#### **NDARJA, BASHKIMI DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vednimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.”

Kompetencat e Administratorit si përfaqësues i shoqërisë mund të shtohen apo të reduktohen me vendim të ortakeve.

**Neni 18****MOSMARRËVESHJET**

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te lindë midis Shoqërise dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykatat e Republikës se Shqipërise.

**Neni 19****PERGJEGJËSITË**

Shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet e marra për qëllime që nuk përputhen me ato të përcaktuara nga Statuti. Shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet e marra nga ortaku në emrin e tij personal ndaj personave të tretë.

**Neni 20****DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

Ky Statut hyn në fuqi ditën që e aprovojnë Themeluesit e Shoqërisë.

Për të gjitha çështjet që nuk janë përcaktuar me këtë Statut do të aplikohen dispozitat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

Tiranë më, 08 Tetor 2022

**Themeluesi**

Fran Marku

---